

PROCES – VERBAL

I mbajtur sot në Tiranë në datë 5 Maj 2015 në orën 14:30 në Ministrinë e Shëndetësisë ku u zhvillua procesi i votimit për anëtarë të Shoqërisë Civile në MKV dhe konkretisht për përfaqësuesit e Grupeve në Risk për dy pozicione në MKV (një me konflikt interesi dhe një pa konflikt interesi).

Organizatat pjesëmarrëse në këtë votim, të shpallura si të kualifikuara nga ana e Komitetit të Rinovimit të Anëtarësisë që kanë *plotësuar kriteret* dhe kanë paraqitur gjithë *dokumentacionin* e kërkuar, janë:

1. Aksion + (me konflikt interesi)
2. STOP AIDS (me konflikt interesi)
3. NCCS (pa konflikt interesi)

Si përfaqësuesë të subjekteve të lartë përmendura, të kualifikuara për në fazën e dytë të votimit dhe të legjitimuar si përfaqësues të këtyre organizatave në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre në paketën e aplikimit, u paraqitën respektivisht;

1. Z. Genci Mucollari
2. Z. Arian Boci
3. Znj. Liliana Dango

Në fillim të pranishmit u informuan nga ana e Sekretariatit mbi procedurat e ndjekura gjatë procesit të aplikimit dhe shqyrtimit paraprak të aplikimeve si dhe për procedurat e mëtejshme që do të ndiqen deri në përfundim të procesit të zgjedhjes së dy anëtarëve të rinjë të MKV-s si përfaqësuesë të Grupeve në Risk. Më pas u procedua me pyetje nga përfaqësuesit e paraqitur dhe pas përgjigjeve të rastit nga ana e Sekretariatit, u kalua në votim. Meqenëse ishin kualifikuar tre organizata përfaqësuese për dy anëtarë në MKV, votimi ndërmjet këtyre tre organizatave u gjykua të zhvillohej i fshehtë.

Të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në votim ju shpërnda nga një fletë votimi të përgatitura paraprakisht nga Sekretariati i MKV-s në të cilin parashtroheshin tre opsione të mundshme alternative për votimin;

Aksion +
STOP AIDS
NCCS

Çdo anëtari pjesëmarrës në votim ju bë e qartë se si do të zhvillohet procesi i votimit ku secili prej tyre duhet të vendoste shenjë dalluese në dy nga opsionet e fletes se votimit.

(një votë për veten dhe një votë për një nga dy organizatat e tjera).

Votimi u krye i fshehtë .

Pas përfundimit të votimit u grumbulluan të gjitha votat.

Znj. Manjola Kola në funksionin e saj si Sekretare e MKV hapi të gjitha fletët e votimit në prani të gjithë pjesëmarrësve dhe lexoi me zë të lartë rezultatin e çdonjërës prej tyre, duke e demonstruar fletën e hapur të votimit edhe në mënyrë vizive të dukshme për të gjithë pjesëmarrësit.

Në fund të procesit të numërimit , rezultoi se:

Pjesëmarrës në votim **3**
Vota të numëruara **6**
Vota Pro Aksion + **2**
Votë Pro Stop AIDS **1**
Votë Pro NCCS **3**

Në fund të procesit të votimit, sikur ju bë me dije verbalisht dhe pjesëmarrësve në votim, dy organizatat me më shumë vota rezultuan:

1. Aksion + (me konflikt interesi)
2. NCCS (pa konflikt interesi)

I gjithë procesi u drejtua dhe u dokumentua nga ana e Sekretariatit të MKV-s, si dhe u monitorua nga anëtarët e Komitetit të Rinovimit të Anëtarësisë:

z. Ylvi Selmani dhe z.Jonid Lamllari.

Me këtë rezultat votimi më shumicë votash dolen organizatat *Aksion + dhe NCCS* qe u përzgjedhën për t'u votuar si anëtarë të MKV-s në mbledhjen e ardhshme të MKV-s e cila parashikohet të mbahet me dt. 8 Maj 2015. Në këtë mbledhje mendohet të paraqitet një raport i plotë nga ana e Komitetit të Rinovimit të Anëtarësisë së MKV-s për gjithë ecurinë e procesit të aplikimit, shqyrtimit paraprak të aplikimeve dhe të votimit.

Pas leximit të rezultatit përfundimtar të votimit nga të pranishmit dhe përfaqësuesi i LFA-s nuk pati asnjë kontestim për procesin.

Personat përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit:

Nënshkrimet si më poshtë:

Anetaret e Komitetit te Rinovimit te MKV:

Ylvi Selmani

Jonid Lamllari

Sekretariati i MKV
Manjola Kola